



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 5878 Më 25.10.2023
Br. prot. Dt. 23
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 01/23, datë: 28.02.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, Njoftimit për ankand publik me nr.5567 të datës 25.09.2023, Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës i formuar me vendim nr.01/23 i datës 28.02.2023 përpilon këtë:

Raport

Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave në ankandin publik me nr.5567 të shpallur me datë 25.09.2023, pas hapjes së ofertave me datë 13.10.2023 konstaton se ka ofertuar vetëm 1 (një); Sh.P.K "Eko Drinia" me nr.biznesi 810733403 me pronar Z.Qazim Hoti, me adresë në fshatin Ratkoc, K.Rahovec.

Komisioni në takimin e mbajtur me datë 14.10.2023 për vlerësim të ofertave, konstaton se ShPK "Eko Drinia" i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar sipas ankandit publik me nr. 5567 të shpallur me datë 25.09.2023 dhe i njëjti shpallet përfitues i këtij ankandi, prona e paluajtshme e komunës së Rahovecit-tregu ditor në fshatin Ratkoc, me gjithsejte 80 pikë.

Komisioni i rekomandon kryetarit të komunës në bazë të kompetencave dhe procedurave ligjore të nënshkruaj kontratën me Sh.P.K "Eko Drinia" pas kalimit të afatit të ankesave prej 7 (shtatë) ditëve.

Rahovec, 25.10.2023